



Pranuar / Dorezuar Primjeno/Prodato Received/Delivery	28 - 09 3	viti god year	
Organ /Njesia Org./Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicitna Quantity
SKRIPSHICE	6293/2023		1/5



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1084/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës- Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari-kryetare, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtar me Kaltrina Avdullahi-Prenaj-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën A.nr.1084/2023 të datës 16.08.2023 të parashtruar nga ankuesi _____ me adresë _____

kundër Vendimit me numër 01-Nr.016-44695 të datës 18.07.2023 të Komisionit Disiplinor të Komunës së Suharekës, në çështjen juridike "Masë Disiplinore", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafi 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 27.09.2023, njëzëri mori këtë:

V E N D I M

I. REFUZOHET si e pabazuar ankesa me numër A.nr.1084/2023 e datës 16.08.2023 të parashtruar nga ankuesi _____.

II. MBETET në fuqi Vendimi me numër Nr.01-016-44695 i datës 18.07.2023 i Komisionit Disiplinor të Komunës së Suharekës.

A r s y e t i m

Ndaj ankuesit _____ i punësuar sipas Akt Emërimit me numër 01-Nr-21 të datës 28.12.2011 në pozitën e punës "Ofiqarë " në Drejtorin e Administratës dhe Inspektionit në Komunën e Suharekës, më datë 06.03.2023 Shefi i Gjendjes Civile në Komunën e Suharekës ka parashtruar kërkesës me numër të protokollit Nr.02-104-15794 për inicimin e procedurës disiplinore. Komisioni Disiplinor më datë 04.04.2023 ka nxjerr Vendim me numër Nr.01-016-22321, me të cilin ankuesit i shqiptohet masa disiplinore „Ndalim i pagës në masën 30% për periudhën prej 3 muaj”.

Ankuesi i pakënaqur me Vendimin me numër 01-Nr.016-22321 të datës 04.04.2023, brenda afatit ligjor komfor nenit 12 të Ligjit Nr. 03/L-192 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës, me datën 28.04.2023, ka parashtruar ankesë me numër protokolli 3910/2023 në

Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me pretendimet ankimore se Vendimi i nxjerrë nga Komisionit Disiplinor përmban vërtetim të gabuar të gjendjes faktike, shkelje të dispozitave të Ligjit me numër Nr.06/L-114 për Shërbyes Publik, Rregullores 11/2020 për disiplinën dhe ankesat e shërbyesve publik si dhe Aplikimit të gabuar të gjendjes faktike.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës me datën 23.06.2023, ka nxjerrë Vendim me numër A.nr.687/2023 me të cilin ka obliguar Komisionin Disiplinor në Komunën e Suharekës që të bëjë **Rishqyrtimin** e lëndës për inicimin e procedurës disiplinore ndaj ankuesit

Komisioni Disiplinor në Komunën e Suharekës ne zbatim të Vendimit me numër A.nr.687/2023 të datës 23.06.2023 Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës me datën 18.07.2023 ka rishqyrtuar rastin e ankuesit dhe ka nxjerr Vendim me numër Nr.01-016-44695 përmes së cilit ankuesit i ka shqiptuar masën disiplinore „*Ndalim i pagës në masën 30% për periudhën prej tre (3) muaj*”.

Ankuesi i pa kënaqur me Vendimin me numër Nr.01-016-44695 të datës 18.07.2023 të Komisionit Disiplinor të Komunës e Suharekës, me date 16.08.2023 ka parashtruar ankesë me numër të protokollit 5681/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës, bazuar në dispozitat e Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka kërkuar përgjigje në ankesën e ankueses nga Komuna e Suharekës. Ndërsa Këshilli më datë 18.07.2023 ka pranuar përgjigjen në ankesë bashkë me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka Administruar këto Prova: Ankesën me numër të protokollit 5681/2023 të datës 16.08.2023 nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendim me numër të protokollit 01-Nr.016-2231 i datës 04.04.2023; Ftesë e datës 21.03.2023; Deklaratë e datës 06.03.2023; Kërkesë për tërheqje nga lënda me numër 02/181 e datës 09.03.2023; Kopje e letërnjoftimit; Shkresë e datës 22.03.2023; Raport mjekësor i datës 20.03.2023; Raport mjekësor i datës 07.03.2023; Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 12.04.2023; Përgjigje në ankesë e datës 15.05.2023; Akt Emërim me numër 01-Nr-21 i datës 28.12.2023; Përshkrimi i detyrave të punës i datës 12.12.2023; Vendim me numër 01-Nr-410-16431; Vendim me numër 01-Nr.016-22321 i datës 04.04.2023; Procesverbal i datës 22.03.2023; Procesverbal i datës 27.03.2023; Njoftim me numër 02-181-15512 i datës 06.03.2023; Njoftim me numër 02-181-16229 i datës 08.03.2023; Kërkesë për inicim të procedurës disiplinore ndaj zyrtarit të Gjendjes Civile me numër 02-104-15794 e datës 06.03.2023; Akt përcjellës 01-016-16489 i datës 09.03.2023; Ankesë 02-070-50181 e datës 29.07.2019; Përgjigje në shkresë me numër NR.02/16-51143 e datës 31.07.2019; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë i datës 01 Janar 2021-31 Dhjetor 2021; Formulari për vlerësimin e rezultateve 10.01.2023; E-mail i datës 18.07.2023; Vendimin me numër 01-Nr.016-44695 të datës 18.07.2023 të Komisionit Disiplinor në Komunën e Suharekës; Vendim me numër A.nr.687/2023 i datës 23.06.2023 i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankesa e parashtruar nga ankuesi është e *pa bazuar*, sepse:

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave bazuar në provat e administruara, gjegjësisht Aktin e Emërimit me numër 01-Nr-21 të datës 28.12.2011 ka konstatuar se ankuesi është i punësuar në pozitën e punës „Ofiqar” në Drejtorinë e Administratës dhe Inspektionit pranë Komunës së Suharekës, ndërsa ndaj të njëjtit Shefi i Gjendjes Civile, gjegjësisht Udhëheqësi i tij i drejtpërdrejtë më datë 06.03.2023 ka parashtruar kërkesën me numër Nr.02/04/15794 për iniciimin e procedurës disiplinore me arsyet e dhëna se është pranuar një ankesë nga qytetarja e cila pretendon se i njëjti duke përdorur pozitën e tij të punës i ka premtuar se do ti rregulloj dokumentacionin duke përfshirë edhe aplikimin për vize andaj ajo pretendon se përveç se është dëmtuar financiarisht nga ankuesi është dëmtuar edhe me humbje kohe.

Komisioni Disiplinor i Komunës së Suharekës në zbatim të Vendimit me numër A.nr.687/2023 të datës 23.06.2023 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ka rishqyrtuar rastin e ankuesit dhe më datë 18.07.2023 ka nxjerrë Vendim me numër 01-Nr.016-44695 përmes së cilit ankuesit i ka shqiptuar masën disiplinore „Ndalim i pagës në masën 30% për periudhën prej tre (3) muaj”, me arsyetimin se të njëjtin e ka gjetur përgjegjës për shkelje të rënda disiplinore të përcaktuara me nenin 46 paragrafi 3 nën paragrafi 3.4 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë ku përcaktohet se „përfitimi në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të dhuratave, favoreve, premtimeve ose trajtimeve preferenciale, të cilat jepen për shkak të detyrës” respektivisht Komisioni ka konstatuar se ankuesi ne deklaratën e datës 22.03.2023 e ka pranuar se me palën dhe babain e saj ka biseduar dhe ka ndërmjetësuar që punët e rregullimit të dokumentacionit i kryen djali i tij, andaj Komisioni në bazë të fakteve ka konstatuar se ankuesi për përfitim ne mënyre te tërthortë apo te drejtpërdrejtë ka përdorur autoritetin dhe ndikimin e pozitës së tij në ndërmjetësimin për rregullimin e dokumentacionit te palës dhe se veprimet e tij përbejnë shkelje të rëndë të detyrave të punës të përcaktuara me nenin 46 paragrafi 3 nën paragrafi 3.4 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik.

Kolegji i Këshillit lidhur me pretendimet e iniciuesit të procedurës disiplinore si dhe rrjedhshmërisë së shqyrtimit të lëndës disiplinore ndaj ankuesit, në bazë të provave materiale të lëndës, konstaton se me date 06.03.2023 në adresë të Kryetarit të Komunës së Suharekës se është parashtruar një ankesë nga qytetarja e cila pretendon se zyrtari në këtë rast ankuesi duke përdorur pozitën e tij të punës i ka premtuar se do ti rregulloj dokumentacionin duke përfshirë edhe aplikimin për vize duke i kërkuar edhe një shume të mjeteve monetare ndërlidhur me këtë çështje Ligji Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, konkretisht neni 25 paragrafi 1,2,3, përcakton se: 1. Zyrtari publik detyrohet të respektojë Kushtetutën dhe ligjin dhe të mbrojë interesin e shtetit dhe të drejtat dhe liritë e njeriut. 2. Zyrtari publik ushtron detyrat e tij me profesionalizëm, paanësi, pa diskriminim, në kohë, pa interes personal dhe në përputhje me ligjin dhe kodin e etikës. 3. Zyrtari publik duhet të veprojë në përputhje me parimet e përcaktuara me këtë ligj, kodin e etikës dhe veprimet e tij duhet të jenë në funksion të themelimit dhe përforcimit të besimit të ndërsjellë dhe bashkëpunimit ndërmjet qytetarëve dhe administratës publike”, dhe nenit 28 të këtij ligji ku theksohet se: „ zyrtari publik gjatë punës së tij duhet të jetë i përgjegjshëm dhe gjatë ushtrimit të detyrës mban përgjegjësi të plotë sipas ligjit, për çdo veprim apo mosveprim të tij”, andaj duke marr parasysh faktin se ankuesi në deklaratën e datës 22.03.2023 e ka pranuar se me palën dhe babain e saj ka biseduar dhe ka ndërmjetësuar që

punët e rregullimit të dokumentacionit i kryen djali i tij, Kolegji i Këshillit konstaton se Komisioni Disiplinor i Komunës së Suharekës me rastin e shqiptimit të masës disiplinore *“Ndalim të pagës në masën 30% për periudhën prej 3 muaj”* ndaj ankuesit përmes Vendimit me numër 01-Nr.016/44695 të datës 18.07.2023 ka vepruar në pajtueshmëri me dispozitat e ligjit material, Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe dispozitave të Rregullores Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë, sepse i njëjti ka përdorur autoritetin dhe ndikimin e pozitës së tij „Ofiqar” për përfitime personale e që rrjedhimisht me një gjë të tillë i ka shkaktuar dëme edhe institucionit, respektivisht Kolegji konstaton se ankuesi me veprimet e tij ka bërë shkelje të detyrave të punës të përcaktuar me Ligjin Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe aktet nënligjore për zbatimin e tij në fushën e disiplinës, për më tepër zyrtari publik në rastin konkret ankuesi nuk i është përmbajtur detyrimit për respektimin e ligjit dhe kodit të etikës ashtu siç parashihet me nenin 25 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë.

Po ashtu Kolegji i Këshillit ka analizuar dispozitat e legjislacionit material që rregullojnë fushën e përgjegjësisë disiplinore dhe shqiptimin e masave disiplinore të paracaktuara me nenin 45 dhe nenin 46 paragrafi 3 nën paragrafi 3.1, 3.3, 3.4 3.6 dhe 3.10 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë ku përcaktohet se: *“45.Përgjegjësia disiplinore është moszbatimi apo zbatim jo i duhur i detyrave të punës dhe detyrimeve të tjera ligjore, që përmban elementet si në vijim: 1.1. “ekzistimin e veprimit të paligjshëm apo mosveprimit;” 1.2. kryerjen e veprimit me faj apo mosveprimit; 1.3. ndodhja e pasojës 1.4. ndodhja e dëmit; dhe 1.5. lidhjen shkakësore ndërmjet veprimit të kryer dhe pasojës/dëmit; 46. Shkelje të rënda konsiderohen: 3.1. mos përmbushja e detyrave të punës; 3.3. moszbatimi i dispozitave ligjore për përmbushjen e detyrave funksionale; 3.4. përfitimi në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të dhuratave, favoreve, premtimeve ose trajtimeve preferenciale, të cilat jepen për shkak të detyrës; 3.6 shkelje e përsëritur e rregullave të kodit të etikës në Shërbimin Civil; 3.10. shkelja e detyrimeve të përcaktuara në këtë ligj dhe në legjislacionin në fuqi”* dhe ka ardhur në përfundimin se nëpunësit civil mbajnë përgjegjësi disiplinore në rastet kur konstatohet se të njëjtit me veprim ose mosveprim kanë shkelur dispozitat e ligjit material dhe legjislacionit në fuqi ndërlidhur me detyrat funksionale dhe përgjegjësit e punës për pozitën që mbajnë, mirëpo vetëm nëse për një çështje të tillë plotësohen parakushtet ligjore për zhvillimin e procedurës disiplinore në pajtueshmëri me Rregullores Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë, sikurse personat zyrtar po ashtu janë përgjegjës nëse në cilësi të autoritetit zyrtar përkitazi me mandatin ligjor që buron nga akti i themelimit të marrëdhënies së punës të ndërlidhur me përshkrimin e detyrave të punës në kuptim edhe të nenit 6 dhe 7 paragrafi 1 dhe 2 , dhe nenin 8 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative nëse të njëjtit kryejnë veprime që cenojnë apo shkelin parimin e barazisë dhe mos diskriminimit, parimin e objektivitetit dhe paanësisë, parimin e pritshmërisë së ligjshme dhe të arsyeshme të ndërlidhura me përgjegjësinë për procedurën dhe vendimmarrjen në kuadër të autoritet zyrtar që ushtron sipas mandatit që ia ka njohur ligji material.

Bazuar në të lartcekurat, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, konstaton se mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i ankuesit, me rastin e parashtrimit të kërkesës për iniciimin e procedurës disiplinore, ka vepruar në pajtim me nenin 48 paragrafin 2 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, i cili përcakton se: *“Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë detyrohet të fillojë procedurën disiplinore mbi bazën e fakteve konkrete dhe të provuara për shkeljen e detyrimeve nga nëpunësi civil”*, ndërsa Komisioni Disiplinor i Komunës së Suharekës, me rastin e nxjerrjes së Vendimit me numër 01-Nr.016-44695 të datës 18.07.2023, në mënyrë të drejtë ka konstatuar shkeljen e bërë nga ankuesi, në këtë rast ka vepruar në pajtim me nenin 45 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, sepse ka konstatuar saktë elementet e përgjegjësisë disiplinore si: *ekzistimin e veprimit të*

paligjshëm apo mosveprimi; kryerjen e veprimit me faj apo mosveprimi; ndodhja e pasojës; ndodhja e dëmit dhe lidhjen shkakësore ndërmjet veprimit të kryer dhe pasojës/dëmit, po ashtu masa disiplinore e shqiptuar ndaj ankuesit, është në përputhje të plotë me dispozitat ligjore në fuqi, respektivisht nenin 47 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2, nenin 48 paragrafi 3, nenin 50 paragrafi 1, paragrafi 2 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, nenin 11, nenin 12, nenin 13 paragrafi 3, paragrafi 4 nën paragrafi 4.1 dhe 4.2 dhe paragrafi 5 të Rregullores (QRK) Nr. 11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë, në këtë rast komisionit Disiplinor i i Komunës së Suharekës përveç kësaj vendimin e ka nxjerr duke u bazuar në provat vendimtare që kanë të bëjnë më rastin konkret, dhe të njëjtin e ka arsyetuar në përputhje të potë me nenin 48 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, kështu që pretendimet të ankuesit ndaj këtij vendimi janë pretendimet të pabazuara dhe të pa argumentuar me prova konkrete.

Bazuar si më lartë, Kolegji pasi ka shqyrtuar shkresat e lëndës, e duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.1084/2023

Kaltrina Avdullahi-Prenaj

Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional

Malsore GASHI-BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Suharekës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.